ADEM ZAPLLUZHA

FLUTURIMI I GJINAKLLËS

Redaktor:
Vasil Tabaku-Poet

Recensent:
Vasil Tabaku-Poet

Lektor:
Veli Veliu

Ballina:
Vesel Xhaferi - Çeliku

ADEM ZAPLLUZHA

FLUTURIMI I GJINAKLLËS

"TREND"
2016

Deri sa t'i biem në fund ky libër që nesër do të paraqitet në dritaren time në FACEBOOK

Nga VASIL TABAKU

PESHA E FJALËS NË POEZINË E ADEM ZAPLLUZHËS

Përsëri, një prurje sa origjinale aq dhe e suksesshme në poezinë e Adem Zaplluzhës, me një peshë të çmuar fjale, ku mesazhi është i qartë dhe tepër i thjeshtë, "Jetoni jetën, duajeni atë dhe bëheni të bukur me dashuri, dritë në shpirt dhe guxim" Natyrisht, nuk ka si të ishte ndryshe edhe në librin e tij më të ri "Fluturimi I gjinkallës" Adem Zaplluzha vjen I sigurt në vargun e tij, plot mendim, trajtesë filozofike dhe mesazh të kthjellëta. ka një ligjërim të ëmbël dhe imponues, ku shpaloset jeta me të gjithë përmasat dhe problemet e saj, me dashurinë dhe ëndrrat, me pasionin dhe shpresën , me dhimbjen dhe trishtimin, me mallin dhe kurajon për të jetuar dhe mbi të gjitha me vlerat e rralla të jetës së shqiptarëve kudo që janë. Ai paraqitet me ketë libër dinjitoz si poet dhe magjik si ligjërues i një vargu lirik, plot dritë dhe emocion, ku natyrshëm zgjohen mendime, që e kanë burimin tek poezia e veçantë, origjinale dhe me patos e Adem Zaplluzhës. Sepse këtij poeti vërtet unikal i duhen pak shumë pak për të shkruar një poezi, sepse atij poezia i buron nga brendia e shpirtit.

Shumë pak fjalë
Më duhen për një poezi
Pakëz diell në syrin e pemëve
Edhe më pak shi
Në ashtin e pathyeshëm të tokës

Nga poezia **"Shumë pak më duhet për të shkruar një poezi"**

E kam theksuar edhe në një trajtesë tjetër për poetin Adem Zaplluzha, ka vetëm një univers dhe ky univers është poezia. Autori ndërton situata dhe dimensione të reja në çdo krijim, ndaj edhe në këtë libër gjejmë një seri prurjesh të reja poetike si në konceptimin artistik, ashtu dhe në mesazhet që autori përcjell. Ai ndërton kohën dhe realitetin përballë nesh me një mjeshtëri të dukshme dhe magjike. Adem Zaplluzha duket si një organizëm i lindur për poezinë, një krijues i pashtershëm dhe plotë vlera artistike të rralla. Këtë e dëshmon më së miri edhe libri që autori paraqet për botim **"Fluturimi i gjinkallës".** Një libër që mendoj se do të jetë edhe një kontribut më tepër për poezinë bashkëkohore i Adem Zaplluzhës. natyrisht, autori është i ndërgjegjshëm për peshën e fjalë së vet poetike, njëherësh është edhe entuziast se e di, gjithçka e poezisë së tij i përket vlerave, i përket Kosovës, i përket Shqipërisë dhe gjithë hapësirave ku jetojnë e punojnë shqiptarë. Adem Zaplluzha ndërton me mjaft elegancë, me finesë dhe me dashuri, një figuracion të shkëlqyer që ngërthen

vlerat e vërteta të poezisë së tij të bukur, befasuese dhe mbi të gjitha me mesazhe të qarta dhe tepër domethënëse.

“Rruga është e gjatë
Por ne do ecim deri në pafundësi
Atje i kemi ëndrrat tona
Secilin hap që do hedhim
Do jemi më afër një ëndrre

Ju thash se ne jemi nisur...”

Nga poezia **“RRUGËS NUK I DIHET ASNJËHERË”**

...sepse poeti e di mirë dhe këtë e nënvizon si një lajtmotiv të madh të kohës, asnjëherë nuk ka kthim, ka vetëm ecje përpara dhe vetëm përpara. Mesazhe këto që burojnë nga realiteti i Kosovës dhe vet kohës. Autori në të gjithë librin është përpjekur të ndërtoj një realitet poetik të përafërt me atë që jetojmë përditë dhe e prekim me duar tona, me shpirtin tonë me ndijesitë tona që poeti i sendërton në poezi brilante dhe me vlera gjithëkohore. Autorë të nivelit të Adem Zaplluzhës janë të pakët dhe me vlera, pasi jo gjithkush mund të mbart kaq shumë art dhe mesazhe, kaq shumë dashuri dhe shpresë, kaq shumë dritë në shpirt dhe guxim. Në librin e tij poetik “Fluturimi i gjinkallës” Adem Zaplluzha paraqitet edhe si një prurës i madh risish poetike, me një figuracion të pasur dhe tepër të realizuar. Adem Zaplluzha është një mjeshtër i vërtetë i

metaforës dhe aliteracionit poetik, i krahasimit dhe epitetit, por edhe i metonimisë artistike. Kjo e bënë librin të jetë tejet i afërt me lexuesin dhe padyshim edhe më të realizuar dhe me vlera të spikatura.

"Ajo nuk ishte një njeri
Po ashtu nuk ishte as poezi
Kalonte në heshtje mes lirikave
Dhe në fund të çdo ecjeje
I përqafonte metaforat e kujtimeve"

Nga poezia"**KUR U PAMË PAS NJËQIND VJETËVE**

Një libër që poeti e sjell me shumë pezëm dhe dashuri, me shumë shpresë dhe guxim, për të krijuar një terren të ri artistik. Nuk mund të themi se poeti është tërësisht i ndërsjellët, pasi në një numër të madh poezish gjendet me shumë kujdes ëndrra e Autorit për të kënduar për Atdheun, tokën, njerëzit dhe dashurinë, dhe unë do të thosha se autori këtë gjë e ka realizuar me mjaft përkushtim dhe mjeshtëri artistike. Duke lexuar me mjaft kujdes librin më të ri të autorit mund të them se Adem Zaplluzha ka bërë dhe një punë të mirë me gjuhën dhe funksionin e saj në shërbim të shprehjes së mendimit të tij të thellë dhe mitikopoetik. Gjuha e poetit është mjaft e pastër, e kultivuar bukur dhe me ngjyrime të mëdha artistike si rrallë kush autor tjetër. Pastërtia stilistikore dhe morfologjike krijojnë një harmoni brilante mes vargjeve të poezive të librit, duke krijuar një atmosferë të këndshme për

lexuesit e gjithfarë kategorie edhe për njeriun e thjeshtë edhe për atë elitar apo akademik. Autori është i pranueshëm për të gjitha shtresat dhe nivelet, një vlerë koj tepër e rrallë dhe e çmuar. Nisur nga të gjitha këto arritje të poetit, me të drejtë dua të theksoj faktin se kemi të bëjmë më një autor serioz dhe të suksesshëm, krijues mjaft kërkues dhe dinjitoz, që i ofron lexuesit një poezi mjaft cilësore dhe të realizuar artistikisht dhe me mesazhe të mrekullueshme. Libri i ri i Adem Zaplluzhës mendoj se është dhe një kontribut i ri në lëmin e krijimtarisë së tij të gjerë letrarëartistike, pse jo dhe me risi të spikatura, Ndër të tjera edhe me atë opusin e madh dhe të gjerë të librave të autorit botuar në një shtrirje kohore të madhe. Pa as më të voglin ngurrim, mund të them me bindje se kjo është edhe një përvojë e çmuar dhe e suksesshme, e cila i shton padyshim vlerat poezisë bashkëkohore moderne shqiptare. Ky autor preston të jetë kështu një emër mjaft tingëllues dhe mbi të gjitha me vlera të larta artistike në këtë lami të artit të të shkruarit, ku unë theksoj edhe faktin se Adem Zaplluzha është kështu një dimension i ri i poezisë sonë moderne dhe një prurës i ri i risive letrare përmes një figuracioni të spikatur,brilant dhe domethënës. i uroj suksese autorit me këtë libër të ri poetik dhe begati krijuese.

Tiranë, 11 Nëntor 2015

Malli i shiut

Cikli i parë

FLUTURUAN PËRTEJ FJALËVE TË ERËS

Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Po bien si zërat e shirave
Po bien gjethet vjeshtës
Bashkë me gjethe po bie edhe vjeshta
Kjo kohë e ngrysur paska mbetur
Jashtë hapësirës dhe mendjes

Në të gjitha lagjet
Mbrëmë nuk pushuan ulërimat
Si ujqërve në kope
I dëgjuam britmat e drurëve
Rrënjët prej mishi këndonin një serenatë

Më duket se ishte koha e dyndjeve
Asnjë lejlek
Nuk kishte mbetur nëpër çati
Vetëm lehjet e ullukëve
Dëgjoheshin në stërkalat e imta të shiut

Më duket se mbrëmë vdiq vjeshta
Vdiqën edhe meteorët
Disa zogj klandestinë
Fluturuan përtej fjalëve të erës
Një shi i myktë binte mbi flokët e drurëve

DJE ISHTE NJË TJETËR DITË
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Tani veç po ecin drurët
Gjethet e zverdhura
Kanë zënë vend nëpër skutat e rrugëve
Kjo stinë e dyshimtë
Po zbret si urithi në parzmën e tokës

Dimri sivjet shumë më herët
I tregoi dhëmbët
Asnjë qen më nuk i leh hënës
Në stanet e çobanëve
Vetëm një heshtje e tunxhtë
Llamburit monopateve

Dje ishte një tjetër ditë
Buzëqeshnin gjethet dhe drurët
Po ashtu edhe shirat s’dukeshin askund
Një heshtje para stuhisë
I mprehte dhëmballët e thyera

Lëvoret e drurëve shikonin me nostalgji
Shikonin të trishtuar
Ikjen tinëzare të vjeshtës
Pemët kokulur nëpër pemishte
Për herë të parë përjetonin
Zverdhimin e gjetheve duke rënë në tokë

MBASE QANTE FATIN DHE MJERIMIN E JUDËS

Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Për çudi
Dëgjohej vetëm zëzëllima e erës
Nga duart e këputura të pemëve
Pikonin frytet e përflakura

Dielli kishte ikur pas bjeshkëve
Nëpër aletë e qytetit
S’pushonin të lehurat e kalimtarëve
S’pushonin as krakëllimat e korbave

Më duket se ishte nata e fundit
Në sofrën e shtruar mungonte fjala
Ose vetë sofra
Mungonte në brendinë e secilës fjalë

Ishte ose nuk ishte aty njeriu
Një aromë fluide
Ngjitej mureve të lagshta
Ngjitej si kërmijtë e sëmurë nëpër kujtesë

Askush nuk qëlloi brenda fjalëve
Një hije tinëzare zvarritej pranë sofrës
Lotonte njeriu me sy të kaltër

Mbase qante fatin dhe mjerimin e Judës

PËRQAFONTE PËRMENDOREN
E BRONZTË
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Mbrëmë tmerrësisht kollitej mali
Në pijetore
S’ndalej gogësima e dehur
Tavolinat vallëzonin vallen e mortit
Një nënë e moshuar
Përqafonte përmendoren e bronztë

Dielli disi shikonte me xhelozi
Kalimtarët e vonuar
Edhe kajsishtat në kopsht
Vuanin nga një sëmundje e panjohur
E tërë lagjja e evgjitëve
I binte daulleve prej letre

Atë ditë nuk pata kohë për asgjë
Kollitjet e pandërprera
S’kishin të pushuar
Mbase kollitej e tërë bota

Në lotin e një nëne të moshuar
Përmallshëm dëneste një erë e akullt

MALËSORÇE KËNDONTE NJË KËNGË MAJE KRAHU

Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Të vdekurit nuk shkuan në varre
Kolona ecte mes kolonadave
Një hije e trishtë
Mbase mbante në duar
Kufomën e një nate të vrarë

Asnjë njeri nuk mbeti te pemët
Selvitë e përkulura deri në tokë
Preknin shijen e dhembjes
Preknin duart e thyera
Nëpër istikamet e kujtimeve

Thashë se të vdekurit nuk shkuan në varre
Ama as të gjallët
Nuk iu përkulën trishtimit
Vetëm një nënë malësore
Malësorçe këndonte një këngë maje krahu

S’pushonte as zëri i korit të lisave
Si në ndonjë enigmë tundej i tërë mali
Një iso fantazmagorike

Për herë të parë u dëgjua
U dëgjuan cicërimat e rrënjëve
Dhe këngët e sirenave në fund të Adriatikut

ASNJË NJERI S'MBETI TE KUJTESA
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

I kryqëzuar si dru varri
Shikon gurin e murrmë
Hijet klandestine
Shkasin si kokrrat e kripës në mol

Deti përkundet në djepin e etjes
Kjo kripë e hidhur djerse
Përjeton metamorfozën e gurit
Mbi syprinën e dallgëve këndojnë meduzat

Një djep i lashtë fëmijërie
I përkund ëndrrat e njomëzakëve
Rrënjët haptazi dolën fushës
Një muzikë mortore dëgjohet te varret

Asnjë njeri s'mbeti te kujtesa
Ikën edhe zogjtë shtegtarë
Çfarë të bëjë me duart e erës
Si ta thyej shpirtin e kristaltë të durimit

TË ÇARAT E SAJA QENKAN RRITUR
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Asgjë nuk paska ndryshuar këtu
Po ajo dhomë e ngushtë
Muret e lagshta
Dhe oxhaku që asnjëherë nuk iu zu fryma

Më kujtohet kjo dritare e vockël
Xhamat e djersitur prej gazete
Dhe dera që mezi merrte frymë
Më duket se vuante nga astma

As tavolinën nuk e paskan prekur
Çdo gjë rri në një qetësi relative
Vetëm dyshemeja paska ndryshuar
Të çarat e saja qenkan rritur

Llamba e vajgurit duket si përherë
Krenare me dritën e saj
Llamba e cila asnjëherë nuk iu përkul
As mikut e as armikut

NGA SYTË E PËRLOTUR TË LISAVE
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Pas betejës nëpër istikame
Pamë këpucë të shqyera
Thundra kuajsh dhe nofulla qensh
Atdheu dukej si një leckaman
Flamujt nudo Pa kockë e lëkurë
Përjetonin katarzën e fundit

Dielli lakuriq i përngjante
Hënës së dhunuar
Nga sytë e përlotur të lisave
Çurgonte dhembja e ditës
Nënat me kërthinjë
Përkundni të nesërmen e nakatosur

Asnjë njeri në fushëbetejë
Vetëm korbat dhe kukuvajkat
Krakëllinin si zogjtë më të trishtuar
Këndesat nuk e lajmëruan mëngjesin
Kurse mbrëmja dukej si një parathënie
Deri te e cila askush s’ka për të mbërritur

DALLGË GURËSH TË BARDHË
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Ndoshta është koha
T’ua ndërrojmë emrat luleve
Po ashtu edhe gjininë
Sot tërë ditën nuk ra shi
Na spërkatën vetëm lotët e luleve

Ishte një natë sterrë
Kur kuptuam se një dorë e zezë
I kishte shkulur zambakët
Nëpër çatitë e kasabasë
Atë mëngjes s’kishin kënduar gjelat

Më thanë se edhe rrugët ishin tkurrur
Qepenat e vjetër nga një siklet
I pashpjegueshëm
Kishin përjetuar të çarat e fundit
Lumëbardhi s’kishte mbërri deri në qytet

Vetëm vajet dhe piskamat e nënave
I kishin zgjuar plepat
Ishin zgjuar edhe kalldrëmet
Dallgë gurësh të bardhë
Kishin vërshuar shpirtrat e vrarë të njerëzve

NËPËR RRUGICAT E NGUSHTA TË KASABASË
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Sonte herët paska rënë mbrëmja
Disa të panjohur
Hynë në oborr
Dhe i shkundën deri në rrënjë drurët

E tërë vjeshta e molisur
Qëndronte e shtrirë nën pemët e zhubravitura
Degët lakuriqe
U ngjanin flamujve të grisur të luftës

Çdo gjë sonte ka një tjetër pamje
Edhe shijet e portokajve
Kanë marrë një ngjyrë rozë
Duken si kuajt e lodhur
Në ndonjë fushëbetejë

Nuk pashë njerëz nëpër rrugë
Trotuaret dhe vitrinat
Ngjajnë zogjve prej letre
Një kalë prej dylli
Pandërprerë hingëllonte në drejtim të qiellit

Hëna e zhveshur deri në asht
Qëndron ballë për ballë me pasqyrën
Nëpër rrugicat e ngushta të kasabasë
Dëgjoheshin vetëm lehjet e lukunive

RRUGËS NUK I DIHET ASNJËHERË

Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Rruga është e gjatë
Por ne do ecim deri në pafundësi
Atje i kemi ëndrrat tona
Secilin hap që do hedhim
Do jemi më afër një ëndrre

Ju thashë se ne jemi nisur
Ecja nuk ka të ndalur
Ëndrrat nuk i kemi në fund
Por në fillim të rrugës
Do i marrim edhe zhgjëndrrat me veti

Rrugës nuk i dihet asnjëherë
Por s'do të kemi të ndalur
Se përndryshe nëse ndalemi
Kurrë nuk do të mbërrimë
Të takohemi me ëndrrat tona

PËRJETON NDRYSHKJEN E BINARËVE
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Sa herë që fshihemi në vetvete
Ne shkasim edhe më thellë
Në gjakun tonë
Sytë na mbyllen si portat e plumbta

Pranë urave që i lidhin brigjet
Në të dy anët e lumit
Dëgjohen lehjet e erës
Dëgjohen krakëllima të çrregulluara

Algat pa itinerar
I kanë humbur të gjitha shpresat
Trenat e dyshimtë
Asnjëherë nuk ndalën në asnjë stacion

Vetëm ora e varur në mur
Përjeton ndryshkjen e binarëve
Kurse shiu i çmendur
Kalon rrugës tërmal me këmishë të bardhë

Prishtinë, 29 tetor 2015

MALLI I SHIUT
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Zëri ishte i vetmi tingull
Që dëgjohej në brendinë e dhomës
Fjala rozë
Më duket se ngadhënjeu atë çast

Asnjë kukuvajkë s’doli nga drita
Ato ishin bijat e sterrës
Në sytë e tyre
Kishte zënë vend mallkimi

Më thanë se është nata e fundit
Por as nuk e pashë dhe as s’e përjetova
Natën e parë të kërshëndellave
Kryqit i binin si daulleve të kushtrimit

Pas largimit të lejlekëve
Qielli ishte i pakuptimtë
Kur e prekëm mallin e shiut
Atë mëngjes të hershëm ikën trenat e fundit

I PREKTE KRONIKAT E KUJTIMEVE
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Kishte mbetur si kërcu i vetëm
Në heshtje iu bashkua
Zërit të shiut
Me duar të fishkura prej mishi
Llamburiste nëpër palcën e dhembjes

Asnjë njeri pranë saj
E kishin harrua edhe hijet e plagosura
Merrte frymë si një gjeth i venitur
Nën degët e thyera të manit
I shfletonte letrat e dashurisë

Me gishtat e saja të holla
Prekte kronikat e kujtimeve
E prekte të kaluarën gjëma e së cilës
Dëgjohej thellë në mushkrit e hapësirës
frymëmarrja e rënduar i ngjante
Frymëmarrjes së peshkut të sëmurë

Më duket se nuk pati shumë kohë
Iku me fluturat e para të mëngjesit
As hija e saj nuk i mbeti peng rrugicave
As kryqi i thyer
Vetëm pendlat e zogjve të egër
Na i miklonin kujtimet e plagosura

ÇDO GJË SONTE ËSHTË NË RRËNJE E SIPËR

Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Disa njerëz vijnë
E disa të tjerë
Ikin pa lënë asnjë gjurmë
Mbi çatitë e rrënuara me tërë peshën e saj
Lëshohet dhembja

Bie edhe nga pak shtrezë
Po ashtu edhe një shi i vaktë
Bien edhe meteorët
Çdo gjë sonte është në rrënje e sipër
Si kërpudhat e mykura
Po bien perënditë

O Zot çfarë të bëjë
Me këtë vetmi të padurueshme
Askush pranë varrit të vithisur

Paskan ikur edhe kryqet
Vetëm një zog i trembur
Dënes mbi një gur të murrmë

Kjo llahtari e pa përshkruar
Ngjan vetëm në qytetin e ëndrrave
Në gjumin e kujt hynë mbrëmë
Dhembjet e plumbta të shiut
Sa dhembshëm dëgjohej
Kënga vajtuese e mështeknës

NË TË DY ANËT E QYTETIT
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"
Rrugëve kalojnë njerëz të lodhur
Kalojnë ngarkuar
Me nga një dhembje në shpinë
Kurse mbi pemët lakuriqe
S'kanë ku të ulen zogjtë

Asnjë gjeth s'ka mbetur te degët
Mbase as degët s'shihen
Mjegulla e dendur paska zbritur
Deri te shpirti i rrënjëve
Andaj edhe s'pushojnë gjëmat

As brigjet e lumit
Nuk janë në gjendje më të mirë

Në të dy anët e qytetit
S'pushojnë të lehurat e lukunive
Një zezonë qëndron pezull mbi çatitë

Fëmijët më nuk dinë të qajnë
E as të këndojnë
Kush e di se si
Por u mishëruan me gjuhën e vajit
Mbrëmë më thanë se plepat po qajnë
Një ogur i zi rri si saç mbi kokë

NGA SYTHAT E PEMËVE TË EGRA
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Flutura të grisure prej letre
Dhe pëllumba të egër
Qenkan ulur mbi pemët e qytetit
Hëna posa doli nga eklipsi
Një tjetër diell
Po duket mbi Bjeshkët e Nemuna

Për çudi paskan heshtur orët e liga
Nga një baladë e vjetër
Furishëm doli një kalë i bardhë
Dhe mbi dymijë vjet e më shumë
Nuk e ndali vrapin
Po ashtu edhe hingëllimën

Hingëllojnë edhe drurët
Gjethet nostalgjike
Paskan zbritur deri te rrënjët
Një kohë e re posa ka filluar
Nga sythat e pemëve të egra
Kanë zënë fill e po çelin zambakët

KALOJNË NËPËR NJË BOSHLLËK TË ERRËT
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Gjërat pa ngjyrë dhe të shurdhtë
Asnjëherë nuk i shohim
Kanë një tejdukshmëri të kristaltë
Herë ngjajnë me ujin
E herë
Me thellësinë e detit të verbët

Një ditë na duken të veshura
Me pantallona të gjata
Kurse ditën tjetër
Kalërojnë nëpër një boshllëk të errtë
As këmishë nate nuk kanë
Në shpirtin e tyre nudo

Vetëm një tis tejdukshmërie
Lëvaret si pjergulla e ngarkuar me fryte
Kështu që

Në shikim të parë
Na duket si një pasqyrim optik
Pas së cilit vrapojnë mushkonjat e verdha

Kjo shurdhëri e dylltë
Jehon në shqisat e të dëgjuarit
Dhe sa ora shndërrohet në uragan
Koka e jonë i ngjan daulles
Ose zërit
Të ndonjë thirrme të imagjinuar

SI NJË VARKË E PËRHUMBUR
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Ishin të kota trokitjet tona
Trenat kurrë më nuk erdhën
Në stacion

Më duket se ishte dimër
Ose fillimi i pranverës
Por lulet ende s’kishin çelur

Era ishte fshehur pas shtrojerës
Vetëm zëri i gjelit
Ja prishi gjumin e mëngjesit

Në qiellin katran
Si një varkë e përhumbur
Notonte Hëna

Gjërat atë ditë
Kishin ndryshuar formën dhe shijen
Dukeshin si zogjtë prej argjile

Më duket se nuk kishim më kohë
Domosdo na duhej të ecnim
Në fund të rrugës na prite ëndrra e jonë

SECILI JETONTE ME BESIMIN E VET
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Sa herë që u thashë miqve
Se përjetësia nuk ekziston
Ata kurrë nuk më besuan
Shikonin drurin e kalbur
Kah e ëndërronte përjetësinë

Ata besonin në diçka imagjinare
Besonin në atë që s'mund ta preknin
Por prapëseprapë besonin
Kurrë nuk ua prisha qejfin
Secili jetonte me besimin e vet

Ndonjëherë ishte dimër
E ndonjëherë diellin përcllues
Dukej si një saç i përskuqur
Ata sërish besonin
Se në të dy brirët e demit
Qëndronte kjo botë gënjeshtare

Le të besoj kush çfarë të dojë
Hëna nuk është as kungull
E as ndonjë pjepër i çarë
Por një copë toke
E cila noton në galaktikën ekzistuese

VJESHTA PËRFUNDON LOJËN E SAJ
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Përtej Urës së Gurit
Në një mënyrë tejet të shthurur
Lozin patat e egra
Mbase është fundi i vjeshtës
Për këtë kor të paorganizuar

Fluturojnë prej një ane
Në anën tjetër të brigjeve
Herë i dëgjojmë zërat e egra
E herë këndojnë një lloj ninullash

Të cilët ne kurrë nuk i kuptuam

Por askush nuk bezdiset për këtë
Kuptuam ose jo
Këto ninulla patash
Vjeshta e përfundon lojën e saj
E përfundon para ardhjes së dimrit

Më pastaj patat sërish ringjallen
Nëpër këneta fjalësh
Njerëzit ndërtojnë përmendore
Dhe me padurim presin pranverën
Për disa ninulla të tjera zogjsh

Fluturimi i gjinkallës

Cikli i dytë

FLUTURIMI I GJINKALLËS
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Të kujtohet
Kur të pata thënë haptazi
Se dashuria është gjinkallë
Sa ora fluturon në një tjetër çerdhe

Si gjithë të tjerët
Nuk më besove as ti
Bile më kujtohet se sa shumë qeshe
Me pantomimën e erës

Mbas disa viteve të brishta
Pranove se kisha të drejtë
Por atëherë ishte tepër vonë
Gjinkalla veç kishte fluturuar

Ti mbete me një pasqyre në dorë
Herë e shikoje xhamin e kristaltë
E herë rrudhat e zhubrosura
Nën lëkurën e ndryshkur të zhivës

Kurse vitet kalonin e kalonin
Ne vetëm i përcillnim fluturimet e zogjve
Mbetëm në të njëjtin kërcu
Duke dëgjuar
Këngën e papërfunduar të gjinkallës

KUR U PAMË PAS NJËQIND VJETËVE
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Ajo nuk ishte një njeri
Po ashtu nuk ishte as poezi
Kalonte në heshtje mes lirikave
Dhe në fund të çdo ecjeje
I përqafonte metaforat e kujtimeve

Me duar të lëngëta e të brishta
Për çdo mëngjes i krihte flokët e erës
I ngjante fluturave të kaltra
Ishte mikesha e luadheve
Mikja ime e fëmijërisë

Kur u pamë pas njëqind vjetëve
Me ne filloi të qeshte edhe stoli
Unë me bastunin tim të vjetër
Kurse ajo si një pemë posa e mbjell
I ngjante luleve më të bukura të qytetit

Me habi shikuam njëri-tjetrin
Unë i shikoja lulet në flokët e saja
Ajo bastunin
Dhe vitet mbi shpatullat e mia
Që të dy aq shumë qeshëm atë ditë
Sa që u përtëritëm për njëqind vjet

NËSE TË ÇMENDURIT DASHUROJNË
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Ju lutem
Më leni të qetë
Sonte dua të jem me pikëllimin tim
Kjo serenatë e mbrëmjes
U përket zogjve klandestin

Nuk është hera e parë
Por as e njëqindta
Kush e di se sa herë u zgjova
Dhe sa herë rashë në gjumë
Duke ëndërruar pranverën në flokët e saja

Më thanë se jam i çmendur
Unë qesha me gjithë botën
Nëse të çmendurit dashurojnë
Atëherë u binda se ata qenkan
Njerëzit më të lumtur në botë

KY LUMË I DALLDISUR
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Fli sonte të lutem
Fli si një kërthi
Nesër kur të zgjohet dita
Pemët do çelin
Lulet më të bukura në botë

Ky lumë i dalldisur
Që po i përqafon brigjet
Do depërtoj në ëndrrën tënde
Fli të thashë
Fli për hir të luleve

Kapma dorën
Afroma edhe ti dorën tënde
T’i zëmë të gjitha ato ëndrra
Që burojnë sonte
Nga lumi i shpirtit të bekuar

ME AFSHIN E NJË PEME
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Mes përmes fushës
Të paanë të mëllenjave
Po çelin lule bozhuret
Po çelin zogj prej dashurie

Diku në horizontin e largët
Përtej shikimeve tona
Me afshin e një peme
Po puthen dy gjinkalla

Era dhe mjegullat
I paskan ndryshuar itineraret
Fli sonte e dashur
Fli në ëndrrën time të zgjuar

KUR I HUMBA DUART
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Më duket se ishte ajo
Ose ishte hija e saj
Por gjithsesi
I përngjante fijeve të barit
Në fillim dhe në fund të stinës

Pranvera kishte çelur

Disa lloje lulesh
Por ajo më e bukura
Ishte vetë lulja
Në syrin e saj prej qielli

Kur i humba duart
Nuk më mbeti asgjë tjetër
Përpos hijes së saj
Që më përcolli deri në varr
Bile edhe përtej varrit

LUMI MË THA ME QESËNDI
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Këdo që pyeta
Të gjithë më thanë
Se ajo i përngjan dashurisë
Kë ta pyes vallë
Se si duket dashuria

Lumi më tha me qesëndi
Se dashuria është fluide
Rrapi pohoi të kundërtën
Kujt t'i besoj në këto çaste
Drurit të njomë ose gurit të mykur

I pyeta zogjtë në fluturim
S'lashë grua në rrugë pa e ndalur

Mbase s’takova asnjë njeri
Të më tregojë
Se si duket dashuria

IKE VËRTIK
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Më kujtohet dita
Kur dilje nga uji moj mike
I përngjaje sirenave të Uliksit
Njelmësia e lëkurës tënde
Ia lëpinte buzët e diellit

Më kujtohen edhe flokët e tua
Dhe stërkalat e detit
Që binin në tokë
Ti ishe alfa
Kurse ecja e jote omega

Kurrë më nuk u pamë
Ike vërtik
Çasti kur dole nga dallga
Mu fiksua në mendje
Si në ndonjë aparat fotografik

TI ISHE I ZBRAZËT SI ERA
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Nëse asgjë tjetër
I pamë ethet e tua atdhe
Dimri ishte i gjatë
Kurse netët e acarta
Vuanin nga dashuria

Pamë edhe kolona njerëzish
Ecnin nëpër binarë
Si shpirtrat e trenave
Ecnin të zbrazët
Pa fije dashurie në shpirt

Kështu ishin ato çaste atdheu im
Kurse ti i sëmurë
Lëngonin rrapet dhe rrënjët
Lëngonte dashuria atdheu i im
Ti ishe i zbrazët si era

SA ËSHTË E ZHVESHUR KJO DASHURI
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Për të mos i humbur
Ne i gjuajmë kujtimet në harresë
Fjalët i fshehim brenda mendjes
Dhe mendojmë se
Kurrë nuk do t’i përngjajmë të fshehurës

Orë e çast pyesim vetveten
Ku ishim dje
Dhe ku do vemi sot
Nga kush do i fshehim ëndrrat
Kjo dashuri po i kallë drurët

Asnjë pemë nuk paska mbetur në kopsht
Nuk dinë më
Në cilën degë do ulen gjinkallat
Sa është e zhveshur kjo dashuri
Sa që nuk i ngjan asnjë fluture

FRYMËMARRJA E SHARRIT UTURIN
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

I mbështetur për trupin e trampolinës
Shikoj kah vdesin fluturat
Një zjarr i madh digjet pranë yjeve

Digjet si malli për dashuri

Disa njerëz ecin horizontalisht
E disa të tjerë vertikalisht
Po ashtu secili në mënyrën e vet
Dashuron në heshtjen më të madhe

Një zambak i verdhë për çdo mëngjes
Bisedon me Lumëbardhin
Frymëmarrja e Sharrit uturin
Uturin si dallga e detit të tërbuar

Peshqit në heshtje
Dashurojnë bunacën
Brigjet e mrrolur të Adriatikut
Përtypin kujtimet e një idile të lashtë

Prishtinë, 30 tetor 2015

VETËM GISHTAT E VEGIMEVE
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Po shoh fare mirë po shoh moj
Se vjeshta paska mbërri
Mbi flokët e tua
Kjo stinë e kërrusur po i zbardhë fushat

Asgjë përpos kujtimeve

S’paska mbetur në degët e kajsive
Vetëm gishtat e vegimeve
Çmendurisht lozin me thinjat e vjeshtës

Një ditë e dërmuar po ecën ngadalë
Po ecën nëpër kujtime gjethesh
Po noton moj e zverdhura kohë
Po noton nëpër dallgë kujtimesh

Edhe këto imazhe do përfundojnë një ditë
Gishtat e çative mbase qenkan fishkur
Vetëm stoli dhe gjethet në park
Ende na presin me duar të hapura

PËRSE TË MOS QAJ SONTE
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Përse të mos qaj sonte
Asnjë pemë s’paska mbetur në këmbë
Dal ngadalë po na vdesin kujtimet
Si vegime të trishtuara
Po zbresin ditët mbi thinjat tona

Më thuaj pra moj mikeshë
Përse të mos qaj sonte si kalama i llastuar
Asnjë gjeth vjeshte
S’paska mbetur gjallë në rrudhat e stinës
Si në ndonjë ëndërr po vdesin degët

Më thuaj pra miku im i fëmijërisë
Për ku janë nisur këto degë të thyera
Përgjoi zërat e erës
Përgjoi kujdesshëm çastet e thirrmave
Sa bukur imitojnë gjëmën e Drinit të Bardhë

SIKUR TË ISHIM NË GJENDJE
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Le të mbushen sonte këto gota
Le të mbushen
Derisa i prekim këto çaste
E të mos zbrazen asnjëherë

Sikur të ishim në gjendje
Ta ngrimë kohën
E të zgjohemi jerm
Pas njëmijë e një vjetëve

Sa do të kishim pas mall
Për këto gota të mbushura
Sa do të kishim pas mall
Për një rimbushje të dytë

KURSE NË MENDJEN E SAJ
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Ajo me dorën e majtë
I mbyllte dritaret
Kurse me të djathtën
Prekte zemrën e shalqirit të pjekur

Gjaku i dridhej në buzë
Kishte aq shumë frikë
Sa që i ngjante
Lepurit të trembur në kafaz

Ajo me dorën e majtë
I prekte yjet
Kurse në mendjen e saj
Si një vegim i largët i paraqitej adoleshenca

CILËS DORË TË JA BËJË MASAZHIN
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Sonte asgjë nuk më mungon
Dy lule në vazon e thyer
Dhe tavolina me libra
Recitojnë “Poemën e Mjerimit”

Sa të largëta qenkan kujtimet
Cilën ëndërr ta zgjoj sonte
Dhe cilën ta lë
Për ta zgjuar kur vjen vjeshta

Mbase çdo gjë qenka kot
S’mund të zgjohen ëndrrat e vdekura
Cilës dorë të ja bëjë masazhin
Më duket se qenka ndalur koha

NJË PALLTO E VJETËR DHE VALIXHJA
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Nëpër trotuare ecin gra
Me fytyra të mavijosura
Ecin edhe qepenat
Kalldrëmet ilire shikojnë në heshtje

Sonte çdo gjë është në lëvizje
Lëvizin gjethet e rëna
Me hapa të tunxhta
Parakalojnë pantallonat e shqyera

Një pallto e vjetër dhe valixhja
Çuditërisht nuk i përkasin kësaj kohe
Askush nuk e di
Se nga cila kohë erdhën në lagjen tonë

Nëpër rrugë shkasin pragjet
Shkasin sandalet e kuqe
Kokulur largohen ushtarët dezertorë
Po ashtu zhduken edhe gratë e përdala

ÇDO GJË ISHTE SHKOPSITUR
ATË VJESHTË
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Ajo rrinte në prag
Me mendime të shkopsitura
Nëpër skutat e kohës
I kërkonte mëkatet e rinisë

Fqinjët pohojnë se asnjëherë
Nuk dashuroi
Ishte një kohë e ushtrive të tërbuara

Që i vilte pjergullat pa u pjekur rrushi

Çdo gjë ishte shkopsitur atë vjeshtë
S'kishte njeri në botë
Që mund ta shkapërthente
Dhembjen e saj të pashëruar

ÇFARË TË BËJ ME VETVETEN
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Në këto çaste
Gjërat më duken të largëta
Nuk më kujtohet as fytyra e jote
Sytë dhe prekjet e tua të shpeshta
Asgjë nuk më kujtohet

Më ka mbuluar pluhuri i harresës
Ndoshta kujtimet i kam varrosur
Shtatë pashë në dhe
Çdo gjë e jotja
Më duket si një kohë e largët

Më janë përzier shtjellat e mendimeve
Ngjan që as këpucët
Nuk di ku i kam lënë mbrëmë
Si dhe ku e harrova bastunin

Dhe nga cila pijetore dola

Nuk më kujtohen as titujt e librave
Kjo amnezi
Më ka mbërthyer për kryqin tim
Çfarë të bëj me vetveten
Ku t'i kërkoj kujtimet e harruara

I KAM HARRUAR EDHE VARRET E GJYSHËRVE

Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

S'ka kush më që mund të më ndalë
Do të nisem në atdhe
Me krahët e fluturave të kaltra
Nëse duhet
Edhe me avion prej letre

Por domosdo më duhet të mbërrij një ditë
Më besoni
I kam harruar edhe varret e gjyshërve
Mjerimi më degdisi
Si shumë të tjerë në fund të dynjasë

Nëpër metropolet e Evropës
Më mbeti peng fëmijëria
I njoh të gjitha këto ndërtesa të vjetra

E di se si kolliteshin pemët
As këtu stinët s'ishin të mira për mua

Por ja se mbeta nëpër pijetoret
Mbeta si një qiri që ndizej në heshtje
Pa e ndriçuar rrugën e vet
Ju thashë se s'mund ta ndalë askush
Kthimin tim në atdheun e përvuajtur

TROKET NJË HIJE E ZEZË
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Një varr i bardhë
Asgjë s'dëgjohet përbrenda
Përpos zëzëllimës së mushkonjës
Sytë e vithisur të skamjes
Paskan humbur tërësisht
Në honin e verbët të kujtesës

Përballë mureve të lagshta
Një heshtje e bronztë
Thinisht zgërdhihet
Nëpër qoshet e dhomës
Varfëria përtypë
Kafshatën e fundit të mbrëmjes

Në xhamin e thyer të trishtimit
Troket një hije e zezë
Askush nuk hynë
E as nuk del nga kjo dhomë
Ku përherë dëgjohet
Zëri i sterrës monotone

KUR TË GJITJHË LODHEN
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Sa herë ndryshon stina
Dhe moti
Në lagjen tonë
Për befasinë e të gjithëve
Fillojnë karnavalet e harruara

Njerëzit duken të hareshëm
Varrtari as që di se ku e ka harruar lopatën
Vallëzon edhe ai
Sipas ritmit
Të një muzike arkaike

Dikur vonë shumë vonë
Kur të gjithë lodhen
Po ashtu edhe muzika
Ajo rifillon nga e para udhëtimin
I cili s'përfundon asnjëherë

VETËM HESHTJA BANON NË ATË SHTËPI
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Asnjë derë ose dritare
Nuk paska kjo pemë
Trokas te rrënjët
S’ka kush të ma hapë derën

Po ashtu heshtin edhe gjethet
Secili njeri këtu
I përngjan pantomimës
Trokit sa të duash dritaret s’hapen

Më duket se
Përbrenda dhomës së akullt
Asnjëherë nuk pat jetë as njerëz
Vetëm heshtja banon në atë shtëpi

Mëngjeseve herët
Dëgjohen disa zëra të shthurura
Por kjo ngjan vetëm mëngjeseve
Kur këndojnë gjelat e egër

POSA I ÇEL SYTË AGU
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Një gotë e vockël
Dhe një tjetër gotë përballë gotës
Në pijetoren e dehur vallëzojnë
Me heshtjen e tavolinave

Netët s’përfundojnë asnjëherë
Posa i çel sytë agu
Fillon një tjetër mbrëmje këtu
E cila këndon me tavolinat e dehura

Sa herë bie shi mbi flokët e molit
Dritat inkandeshente të yjeve
Në shpirtrat drithëruese të tavolinave
Herë kyçen e herë shkyçen

POR SOT JAM EDHE UNË
I TËRI PIKËLLIM
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Dikur isha pemë
Rrënjët si damarët e gjakut
Preknin pulsin e tokës
Aq shumë kishte etje shiu
Sa që flinte mes bubullimave

Ju thashë se dikur isha zambak
Në kopshtet më të bukura të qytetit tim
Isha edhe pjalm fjale
Por sot po ecin të kërrusura rrugët
Secila portë mbanë nga një bastun

Dikur isha pemë e cila çelte
Sytha prej dielli
Nga rrënjët e ditës shkulte
Pikëllimin e aromës së trëndafilit
Por sot jam edhe unë i tëri pikëllim

QË TË SHKRUAJ NJË POEZI
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Shumë pak fjalë
Më duhen për një poezi
Pakëz diell në syrin e pemëve
Edhe më pak shi
Në ashtin e pathyeshëm të tokës

Për shumë pak fjalë
Kam nevojë sonte
Dhe për disa metafora të imta
Që të shkruaj një poezi
Për pikëllimin e lotit të gjinkallës

NËN KAJSISHTAT E LAGJES
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Dëgjoj zërin e një largësia
E gjithë bota
Paska hyrë në një kuti magjike
Askush nuk e ndjen
Buzëqeshjen e tërthortë të erës

Nëpër kopshtet e kujtesës
I preki lëvoret e drurëve të njomë
Nën pemët frytdhënëse
Tulatet gjelbërimi
Mbase një frikë e panjohur
Zgjohet në shpirtin e virgjër të barit

Unë sërish dhe sërish
Dëgjoj zërin e një largësie
I tërë universi kollitet
As krakëllimat e korbave
S'paskan të ndalur sonte

Hëna posa doli si nusja
Shëndosh e mirë
Nga përqafimi i eklipsit
Nën kajsishtat e lagjes
Sërish po lind një ditë e re

MË PRESIN FLUTURAT
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Sonte kam të ftohtë
I ndjej në shpirt prekjet e erës
Mali im i butë
Që më mbanë gjallë me frymëmarrjen e barit

Do të nisem njëherë e një ditë
E di që në fund të rrugës
Më presin fluturat
Dhe fluturimet e gjinkallave prej letre

Por domosdo më duhet të nisem
Atje më pret një pemë te koka
Dhe qivuri nga druri i atdheut tim
Më presin stërgjyshërit e mi

Prishtinë, 31 tetor 2015

FALJA EDHE PUTHJET
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Këmishën tënde të mëndafshtë
Falja erës
Falja edhe puthjet
Se vetëm me dashuri rriten pemët

Më pastaj zhvishe lëkurën tënde
Më beso s'do të dukesh nudo
Asgjë s'do të mungoj
Do të të mbulojnë puthjet e mia

Kur i pyetëm zogjtë

Cikli i tretë

NUSET NËPËR OBORRE
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Këtu thonë se nëse qyteti nuk ëndërron
Lumëbardhi e ndërron rrjedhën
Kalldrëmet çohen peshë
Dhe asnjëherë më s’çelin zambakët
Në shuplakat lozonjare të erës

Ditët në qytetin tim janë të gjata
Po ashtu edhe netët
Me mija vjet këtu s’ndalen serenatat
Nëpër secilën derë të hapur
Buzëqesh nga një gjinkallë e lazdruar

Në pragje i shohim plakat flokëbardhë
Duke i endur këmishët
Mu ashtu siç endte Penelopa
I shohim edhe nuset nëpër oborre
Duke i mëkuar kërthinjtë e paslindur

Kur veç dielli shtrihet në shtratin e qiellit
Këngët fillojnë të kulmojnë
Në këtë qytet këndohet në secilën kohë
Edhe kur zgjasin dasmat me javë
Edhe kur i përcjellim të dashurit në amshim

VIJNË ZËRAT E GJYSHËRVE
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Kjo Urë e Gurit
Veç qenka lodhur sivjet
Lumëbardhi herë i buzëqesh
E herë i ngërmohet

Sa herë që kalojnë vashat mbi të
Nga fustanet e larme
Bien të gjitha lulet
Dhe trëndafilat ngjyrë qielli

Algat si algat
Kurrë nuk pushojnë
Së përtypuri në heshtje

Kronikat e kalimtarëve

Sa herë që bashkohen me nekrologët
Pyesin për fatin e myshqeve
Dhe qirinjve
Që ndizen për çdo mbrëmje

Nga varrezat e qytetit të vjetër
Për çdo natë
Na vijnë zërat e gjyshërve
Vijnë dhe pyesin
Për të gjitha llojet e kronikave

Pa masë interesohen
Interesohen se cili politikan u lindi
Dhe cili vdiq mbrëmë
Në mënyrë më misterioze

ZBRESIN STËRKALAT E FUNDIT TË SHIUT
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Kudo lagjeve shtëpi të boshatisura
Nëpër çdo portë e dritare
Hyn dhe del era e akullt
Mbi çatitë e rrënuara
I dëgjoj zërat e gjelave të metaltë

Kanë ikur edhe lejlekët
Shumë herët para se të mbërrij vjeshta
U larguan edhe zogjtë shtegtarë
Vetëm patat e egra
Me fluturime marramendëse laracojnë qiellin

Me nga një bastun arkaik
Retë shpejtojnë kalldrëmeve tërmal
Aty këtu përbrenda oborreve
Dëgjohen të lehurat e shurdhëta
Të qenve endacakë

Nga ullukët e ndryshkur
Zbresin stërkalat e fundit të shiut
Asnjë portë e hapur
E tërë lagja mbyllur me një dry të vjetër
Në këtë gjumë të përdalë ëndërron pranverën

DËGJONIM BLEGËRIMA DELESH
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Dielli i thyer si një pjatë porcelani
Paska rënë në tokë
Disa cifla fjalësh rrokullisen
Tërmal kujtesës
Në perëndim
S’do të mbërri sonte dielli

Patëm edhe ditë më të liga
Kur eklipsi mbuloi tërë tokën
Kurse hëna e zhgënjyer
Shikonte
Shikonte mes gishteve skelet
Kraterin e vullkanit që vidhte zjarr

Nëpër luadhe e shkurre të thata
Dëgjonim blegërima delesh
Çobanët veç kishin marrë arratinë
Një tym i plumbtë
Mbuluar e kishte tokën
Asnjë breshkë uji nuk merrte frymë
Nëpër guroret e thyera çahet toka

NGJANIN ME BRITMAT E NJERËZVE
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Në çastin kur u futëm në ujë
Ndjemë se nuk kishim etje
Po ashtu s’na mundonte as uria
Një zë nga brenda nesh
Uturinte Si hukamë deti

Thirrmat ishin të shurdhëta
Ngjanin me britmat e njerëzve
Të cilit kërkonin ndihmë
Por zëri i përmbytur i ujit
S’dëgjohej as dy hapa më tej urës

Atë ditë binte një shi i trentë
Shiu që i ngjante piskamave të dhembjes
Asnjë njeri nëpër rrugë
E rrugët qorre
Belbëzonin psalmet e vjetra

Sërish po ai shi i çmendur
Derdhet nëpër ullukët e kujtesës
Nëpër mëhallë
Përmbytje pragjesh
Dhe ngordhësira macesh të mbytura

KURSE HAPËSIRA DUKEJ NUDO
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Atë ditë kishim aq shumë kohë
Sa që vizatuam nëpër mure
Shpirtin rebel të erës
Dhe qivurin e gurtë të varrit

Dielli herë ndriçonte
E herë ngrysej
Dhe na dukej si një kazan
I pakallajisur në vitrinë

Hëna kishte ikur nga qielli
Vendin e saj e kishin zënë
Me qindra meteorë endacakë
Kurse hapësira dukej nudo

Kurrë nuk kam parë qiell më të varfër
Se në çastin
Kur ndodhi zënia e hapësirës
I pamë vetëm imazhet e sterrës së paparë

NJË BRITMË DRURËSH TË THARË
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Zogj të ngordhur
Nga parmakët e dritareve

Pikojnë zërat e natës
Një britmë drurësh të tharë
Dëgjohet në thellësinë e rropullive të malit

Përpos britmave asgjë tjetër
Nuk ngjan në teatrin e kujtesës
Perdet ka kohë që janë lëshuar
Por ne asnjëherë
Nuk i dëgjuam duartrokitjet

Si nëpër ndonjë han njerëzit hyjnë
Dhe dalin nga kjo dhomë
Më duket se në këtë qytet
Asnjëherë nuk kanë banuar njerëzit
Përpos fantazmave që kanë bredhur këndej

Zogj të ngordhur dhe trotuaret
Po e përjetojnë zënien e hënës
Fëmijët me nga një qelq të errësuar
Rrinë me sy kah qielli
Shikojnë me habi vallen e lashtë të yjeve

DËGJUAR I KAM EDHE LEHJET E QENVE TË TËRBUAR

Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Mbi këtë tryezë
Sa e sa herë e kam gatuar shpirtin
Kam ndjerë thellë se si qanin
Dhe rënkonin poezitë e pashkruara

E shihja Lulin e Migjenit
Ulur përballë meje
Kalin ngarkuar me qymyr
Se si hingëllonte në një gjuhë kuajsh

Malësoren krenare me fustanellë
Të arnuar me qindra arna
Dhe një dhembje të madhe
Në sytë e saja të kaltër si Adriatiku

Çfarë s’kam parë dhe përjetuar
Mbi këtë tavolinë të vjetër
Kam parë edhe portretin tim surrealist
Dëgjuar i kam edhe lehjet e qenve të tërbuar

KY MUR E KJO PORTË

Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Ky mur i vjetër

Me qindra herë është shpuar nga plumbat
Më kujtohet
Kur para pak viteve
Rënkonte si një lehonë para lindjes

Edhe këto porta të rënda
Çfarë s'kanë përjetuar
I hapnin me shqelma
Disa herë i kemi ndërruar drynat
Sa që akoma i dëgjoj gjëmat e pragjeve

Ky mur e kjo portë
E këta njerëz
Kanë pasur mall për një këngë
Por kurrë
S'patën fat të këndojnë si njeri

Ky qytet muze është lodhur
Nga britmat e egra
Dhe piskamat e lukunive
Por prapëseprapë
Qëndroi stoikisht përballë stuhive

TROKITËN EDHE GJETHET E ZVERDHURA

Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Ajo me gishtat e saja skelet
Trokiti në xham
Dhe u zhduk pas pemëve
Trokiti edhe një gjinkallë
Korbi qëndronte në maje të lisit

Ishte vjeshtë
Trokitën edhe gjethet e zverdhura
Dhe ranë në tokë
Me një pamje habitore
Shikonte stina e ngrysur

Kaluan edhe disa udhëtarë nate
Trokitën dhe sërish u zhduken
Përveç të trokiturave
Nuk ndodhi asgjë tjetër këtu
Një hije e zymtë ende troket nëpër xhama

DY SY SI DY GËSHTENJA

Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Poeti dhembja
Dhe komodina e vjetër
Bisedojnë në heshtje

Me portretin e varfërisë

Dy sy si dy gështenja
Shikojnë pasqyrën e ndryshkur
Skamja e akullt
Është shtrirë bri dhembjes

Poeti pasqyra dhe dhembje
Nuk i ndajnë sytë nga komodina
Bri saj si sogjetar
Stoikisht qëndron portreti i Lulit

KUR I PYETËM ZOGJTË
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Aq të madhe e kishim etjen
Sa që kur mbërrimë te burimi
Pikë uji nuk gjetëm

Kishin ikur edhe zogjtë
Nga ky shkretim
Asnjë stinë nuk kaloi këndej pari

Thonë se me vite të tëra
Nuk kanë kënduar bretkosat këtu
Etja ishte aq e madhe sa që u thanë pemët

Kur i pyetëm zogjtë

Se ku pinë ujë ikën fluturimthi
Kurse ne kuptuam se sa shumë kishin etje

NA MALLKOI ENGJËLLI NA MALLKOI DJALLI
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Nuk më beson askush
Por është një e vërtetë e madhe
Sa herë që i dëgjoja të trokiturat
I fshehja letrat e dashurisë

Fshehja çdo gjë të shkruar në gjuhën shqipe
Të tilla ishin kohërat
Për një abetare
Na syrgjynosnin nëpër burgje

Më duket se s’guxonim të dashuronim
Asnjëherë si njeri
Andaj nëna ime e ndjerë
Nuk e njihte mirë gjuhën shqipe

Nuk më beson askush
Por gjuha ishte mallkim për shqiptarin
Na mallkoi prifti hoxha dhaskali
Na mallkoi engjëlli na mallkoi djalli

ASNJËHERË NUK PAMË DRITË
Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Fjalën e fshehëm nën gjuhë
Për dashurinë
Belbëzonim në ëndërr
Mbi kokë më rrinte shteti
Kurse në mendje hoxha e prifti

Asnjëherë nuk pamë dritë
Na iku njëri pushtet
Për kërpeshi na lidhi tjetri
Herë na sundoi mbreti
E herë dovleti

Tani kur u bëmë vetvetja e jonë
Po na ndjek si hajdutin
Një tjetër zezonë
Nuk pranuam mbret s’pranojmë as pushtet
Xhelozia na ka vënë në siklet

OSE VIZATONIM NËPËR MURE ÇEREPIN

Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Ishte koha e urisë
Asnjë lugë miell në magje
Mbi pemët e thara
Kekllishte gjinkalla

Kishin ikur krejtësisht zogjtë
Vetëm korbat e zinj
Krakëllinin mbi çatitë
Gjysmë të rrënuara

Për ta shuar urinë
Sajonim përralla të bukura
Ose vizatonim nëpër mure çerepin
Ku piqej buka e jonë e përditshme

AS NË PARAJSË E AS NË FERR

Nga libri “Fluturimi i gjinkallës”

Shtëpitë dhe ndërtesat e vogla
Nuk ekzistojnë më
Nuk ekzistojnë as miqtë e mi
Secili prej tyre
Jeton në një tjetër adresë

Dikush në katin e parë
E dikush tjetër në të dhjetin
Ndoshta banesat
Edhe këtu janë ndarë sipas meritës
Por gjithsesi
Edhe në Parajsë ka vend ryshfeti

Sot nuk jam në gjendje
Që t'i takoj miqtë
Tani për tani nuk më shkohet
As në Parajsë e as në Ferr
Këto vende po ua lë atyre
Që meritojnë
E më vonë shohim e bëjmë

KALOJMË NË NJË GJENDJE TJETËR
Nga libri "Fluturimi i gjinkallës"

Më kujtohet kur thoshte im at
Se pak njerëz dinë të vdesin
Sepse edhe vdekja
Duhet të jetë vertikale

Para se të ikim
Nuk mjafton vetëm të bëjmë kryq
Ose të këndojmë ndonjë psalm
Duhet të jemi pakës më të fortë se vdekja

Përpos frymëmarrjes secili njeri
Ka diçka më me rëndësi se shpirti
E ai është dinjiteti
Rruga të cilën e kalojmë gjatë tërë jetës

Për të jetuar dhe për të vdekur
Aq pak kohë na duhet
Sa që derisa i çelim dhe i mbyllim sytë
Kalojmë në një gjendje tjetër

Prishtinë,1 nëntor 2015

SHËNIME PËR AUTORIN

Adem Zaplluzha u lind më 1 shkurt 1943 në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Për një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e Qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë u punësua si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret, - kryesisht me poezi, - që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë, të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Në Korporatën Energjetike të Kosovës, bashkë me shokët e punës e të penës themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Ky i fundit përmbledhjen "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i madh i poezive të Ademit. Krahas krijimeve të botuara në revistat për fëmijë, u paraqit para publikut edhe me

një numër shkrimesh nëpër gazetat e kohës, që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, i pranishëm në disa antologji dhe në librin "Kosova letrare" të poetes Monika Mureshan. Figuron në Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990, të përgatitur nga Hasan Hasani; në Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995 nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002. Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i Shkrimtarëve të Durrësit ie nderoi me Çmimin e Karrierës për ndihmesën që ka dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1."Puthje", poezi, "Rilindja", Prishtinë,1974.
2. "Ecjet e viteve të mëdha", poezi, "Jeta e Re", Prishtinë 1995.
3. "Çamarrokët e Thepores", poezi për fëmijë, "Shkëndija",Prishtinë 1996.
4."Muret", poezi, "Jeta e Re", Prishtinë, 1997.
5. "Morfologjia e dhembjes", poezi, "Faik Konica", Prishtinë,2000
6. "Ai vjen nesër", poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar"Fahri Fazliu", Kastriot, 2oo7
7. "Letër nga mërgimi", poezi, Klubi letrar "Fahri Fazliu"Kastriot , 2007
8. "Letër nga mërgimi 2 " poezi, "Qendra e Kulturës", Klubi
letrar , "Fahri Fazliu", Kastriot 2007

9. “Udhëndarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. “Thirrje e gjakut”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “Puthja e gozhduar”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. “Kashelasha në vargje”, poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.
15. “Pema e bekuar”, E përkthyer, Rumani, 2o1o.
16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. “Hijet e ndryshkura”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18.”Stuhi në Kutulishte”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. “Posa ikte nata”, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o. “Loja e myshqeve”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. ”Lumëbardhi dhe gjëma”, poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22. “Metafora e heshtjes”, poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. ”Hyji në Prekaz”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. ”Sinorët e hinores”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010

25. ”Don Kishoti dhe Rosinanti”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26.”Zjarri i dashurisë”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. ”Kur likenet vallëzojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28. “Ditari në vargje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
29. “Tingujt që nuk përfundojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o. “Shtegu i mallit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
31. ”Korniza e thyer”’,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010
32. “Zgjimi i gjëmës”,Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. “Vallja mistike”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
34. ”Merre kodin”, Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. “ Letër atdheut” poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. “ Tejdukshmëria e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. “ Përtej teje”,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. “Sa afër e sa larg” , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2011
39. “Vallja e zanoreve”, Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. “Ikja e eshtrave”, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11

41.”Kalorësit e mjegullave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. “Hingëllimat e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. “Kur pemët i ndërrojnë këmishët”. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. “Mirëmëngjes Imzot”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45. “Kafshimi i mikut”, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12
48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55. “ Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12

57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60. “ Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
62. “ Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012
63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012
64. “ Lisi në rrënjët e veta” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012

73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
78.“Pyesni zogjtë në ikje ”,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013
79 “ Përfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
83.“Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
84.“Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”Kastriot, 2013
85.“Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot,2013
86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014-
87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot 2014
88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014

89.”Kur dehen perënditë” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014
90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot ,2014
91.”Krakëllimat e natës”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
92. “Ndjekësit e enigmave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014
93. “Atdheu i paçmuar”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
94.”Psalm i harruar ”,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
95,”Për kë po bie moj kambanë”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
96. “Mbi flokët e ullukëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. “Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98. “Loti i gotës së dehur” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99. ” Stina asnjanëse” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. “Dëneste bashkë me erën” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. “Druri i pikëlluar”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
102. “ Një grusht dashuri” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
103. “Lëreni zërin tim” , poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
104. “Shi në qytetin tim” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014

105. . “Si trenat e verbër ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
106. “Zjarri i malli tim ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
107 . “Kur teshtinë era ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
108. “Mbi shpirtin e erës pagane ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
110”Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”- Prishtinë, 2015
111.“Një hënë e zhveshur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”– Prishtinë, 2015
112. “Nëpër plasaritjet e mureve”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”– Prishtinë, 2015
113.“Mes telave gjembor ”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
115.” Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
116”Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
117. “Një shi prej bryme” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ” , Poezi Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015

120. “Yjet e ngrira të kujtesës ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
121. “ Thirrmat e hijeve” , Poezi, Shtëpia Botuese”TREND” – Prishtinë, 2015
122. “Dritaret e verbëta ” , Poezi, Shtëpia Botuese”TREND” – Prishtinë, 2015
123 . “Përtej portave të mbyllura” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
124. “Malli i etjes” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
125. “Kur qajnë pemët ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
126. “Të dielave në qytetin tim ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016

127. “ Nëpër brigjet e kujtesës”Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
128. “Rrugës qante një stërqok” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
129. “Kali im prej bore” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
130. “Përballë hijes së mollës ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016
131. “Jehu i zërave” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
132. “Në kujtesën e pemëve ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016
133.“Më mirë një gjysmë ëndrre ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016
134.“Një dry prej dylli ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016

135.“ Në anën tjetër të mendjes” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016
136.“Sa shumë ethe pat dimri sivjet ” , Poezi,Shtëpia Botuese “TREND “Prishtinë, 2016
137. “Enigmat e kashelashave” , Poezi ,Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016.
138 “Nuk i them unë dot kësaj liri ” , Poezi - Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016
139.“Fluturat prej letre ” , Poezi,Shtëpia Botuese “TREND “Prishtinë, 2016
140 “Fluturimi i gjinkallës ” , Poezi - Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016

PËRMBAJTJA:

Malli i shiut
Cikli i parë 11

Fluturuan përtej fjalëve të erës 13
Dje ishte një tjetër ditë 14
Mbase qante fatin dhe mjerimin e Judës 15
Përqafonte përmendoren e bronztë 16
Malësorçe këndonte një këngë maje krahu 17
Asnjë njeri s’mbeti te kujtesa 18
Të çarat e saja qenkan rritur 19
Nga sytë e përlotur të lisave 20
Dallgë gurësh të bardhë 21
Nëpër rrugicat e ngushta të kasabasë 22

Rrugës nuk i dihet asnjëherë 24
Përjeton ndryshkjen e binarëve 25
Malli i shiut 26
I prekte kronikat e kujtimeve 27
Çdo gjë sonte është në rrënje e sipër 29
Në të dy anët e qytetit 31
Nga sythat e pemëve të egra 32
Kalojnë nëpër një boshllëk të errët 33
Si një varkë e përhumbur 35
Secili jetonte me besimin e vet 36
Vjeshta përjeton lojën e saj 37

Fluturimi mi gjinkallës

Cikli i dytë 39

Fluturimi i gjinkallës 41
Kur u pamë pas njëqind vjetëve 42
Nëse të çmendurit dashurojnë 43
Ky lumë i dalldisur 44
Me afshin e një peme 45
Kur i humba duart 46
Lumi më tha me qesëndi 47
Ike vërtik 48
Ti ishe i zbrazët si era 49
Sa është e zhveshur kjo dashuri 50
Frymëmarrja e Sharrit uturin 51
Vetëm gishtat e vegimeve 52
Përse të mos qaj sonte 53
Sikur të ishim në gjendje 54

Kurse në mendjen e saj 55
Cilës dorë të ja bëjë masazhin 56
Një pallto e vjetër dhe valixhja 57
Çdo gjë ishte shkopsitur atë vjeshtë 58
Çfarë të bëjë me vetveten 59
I kam harruar edhe varret e gjyshërve 60
Troket një hije e zezë 61
Kur të gjithë lodhen 62
Vetëm heshtja banon në atë shtëpi 63
Posa i çelë sytë agu 64
Por sot jam edhe unë i tëri pikëllim 65
Që të shkruaj një poezi 66
Nën kajsishtat e lagjes 67
Më presin fluturat 68
Falja edhe puthjet 69

Kur i pyetëm zogjtë
Cikli i tretë 71

Nuset nëpër oborre 73
Vijnë zërat e gjyshërve 76
Zbresin stërkalat e fundit të shiut 77
Dëgjonim blegërima delesh 78
Ngjajnë me britmat njerëzve 79
Kurse hapësira dukej nudo 80
Një britmë drurësh të thatë 81
Dëgjuar i kam edhe lehjet e qenve të tërbuar 82
Ky mur e kjo portë 83
Trokitën edhe gjethet e zverdhura 84
Dy sy si dy gështenja 85
Kur i pyetëm zogjtë 86
Na mallkoi engjëlli na mallkoi djalli 87

Asnjëherë nuk pamë dritë 88
Ose vizatonim nëpër mure çerepin 89
As në Parajsë e as në Ferr 90
Kalojmë në një gjendje tjetër

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Fluturimi i gjinkallës / Adem Zaplluzha. – Prishtinë : “Trend”, 2016. – 104 f. ; 21 cm.

Shënime për autorin : f. 90-100

ISBN 978-9951-694-45-2